



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL**

**RAPORT**

**PËR**

**MONITORIMIN E PROCESIT TË RISTRUKTURIMIT NË**

**MINISTRINË E DREJTËSISË**

**Tiranë, Tetor 2018**

## RAPORT

### **Për përmbylljen e procesit të monitorimit në lidhje me zbatimin e ligjit për nëpunësin civil, gjatë procesit të ristrukturimit, në Ministrinë e Drejtësisë**

#### **Hyrje**

Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, në mbështetje të nenit 11, pika 1, si dhe të nenit 14, pikat 1 e 2, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, nëpërmjet urdhrin nr. 85, datë 9.10.2017, “Për fillimin e monitorimit të zbatimit të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe të akteve nënligjore, gjatë aplikimit të procedurave në lidhje me procesin e riorganizimit të institucioneve të administratës shtetërore (mbylles dhe ristrukturimit), pas miratimit të përbërjes së Këshillit të Ministrave”, ka vendosur fillimin e monitorimit të zbatimit të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe të akteve nënligjore, gjatë aplikimit të procedurave të ristrukturimit të aparatit të Këshillit të Ministrave dhe Ministrive të linjës.

Bazuar në pikën 8, të tabelës nr. 1, bashkëlidhur urdhrin më sipër, u ngrit grupi i punës me përbërje inspektorët, Ilir Sauli dhe Atalvin Niço, të cilët janë autorizuar nga Komisioneri për të monitoruar procesin e ristrukturimit në Ministrinë e Drejtësisë.

Objekti i monitorimit në këtë institucion është procedura e ristrukturimit, që përfshin të gjitha proceset e legjislacionit për nëpunësin civil, që rregullojnë këtë aspekt, ndër të cilat përmendim, hartimin e përshkrimeve të reja të punës; krijimin e Komisionit të Ristrukturimit; veprimtaria e Komisionit të Ristrukturimit, aktet administrative për propozimin e transferimeve të Komisionit të Ristrukturimit; verifikimi i propozimeve për sistemimin e nëpunësve dhe miratimi i tyre nga Departamenti i Administratës Publike; evidentimi i rasteve të lirimit nga shërbimi civil, respektimi i afateve procedurale nga ana e aktorëve që marrin pjesë në këtë procedurë, etj.

Në përfundim të procesit të këqyrjes së akteve dhe administrimit të dokumentacionit të nevojshëm në institucion, grupi i punës përpunoi të dhënat dhe përgatiti raportin e monitorimit në lidhje me administrimin e shërbimit civil, gjatë aplikimit të procedurave të ristrukturimit në Ministrinë e Drejtësisë, si më poshtë:

#### **Qëllimi i monitorimit**

Qëllimi i realizimit të këtij procesi është:

- Monitorimi, kontrolli dhe vlerësimi i zbatimit të nenit 50, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar; Vendimit nr. 125, datë 17.2.2016, të Këshillit të Ministrave, “Për transferimin e përkohshëm dhe të përhershëm të nëpunësve civilë”; si dhe Udhëzimit nr. 1, datë

1.3.2016, të Departamentit të Administratës Publike, “Për krijimin, funksionimin dhe kompetencat e komisionit të ristrukturimit për shkak të mbylljes apo ristrukturimit të institucionit”.

- Paraqitja e konstatimeve dhe fakteve të evidentuara dhe të vlerësuara si parregullsi në lidhje me zbatimin e ligjit për nëpunësin civil para përgjegjësve për administrimin e procesit të ristrukturimit.
- Paralajmërimin e njësisë përgjegjëse, institucionit dhe personave përgjegjës, në rast të konstatimit të parregullsive gjatë zbatimit të ligjit, duke lënë detyrat dhe rekomandimet përkatëse për përmirësimin e situatës, brenda një afati të arsyeshëm, sipas përcaktimeve të bëra në nenin 15, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar.

### **Metodologjia e monitorimit**

Si metodë pune është përdorur verifikimi i dokumentacionit që ka lidhje me objektin e mbikëqyrjes, i cili administrohet në sektorin e njësisë së menaxhimit të burimeve njerëzore të institucionit, si dhe Departamentit të Administratës Publike. Konkretisht, grupi i punës realizoi veprimet e mëposhtme:

- Fillimisht u realizua një takim dhe bashkëbisedim, në datën 06.02.2018, me \*\*\*\*\*\*, me detyrë “Drejtor”, i Drejtorisë së Miradministrimit të Burimeve Njerëzore, Aseteve dhe Shërbimeve, me të cilit u diskutua mbi objektin dhe drejtimit e mbikëqyrjes, si dhe u ra dakord në lidhje me dokumentacionin shkresor që duhet të vihej në dispozicion të grupit të monitorimit për verifikim. Person i kontaktit me grupin e punës në këtë institucion u caktua nëpunësja \*\*\*\*\*\*, e cila kryen detyrën “Përgjegjëse Sektori”, pranë sektorit të Burimeve Njerëzore.
- U administrua gjithë dokumentacioni shkresor i konsideruar i nevojshëm për realizimin e këtij monitorimi, e konkretisht: struktura aktuale dhe struktura mëparshme; listë prezencat para dhe pas ristrukturimit; disa modele të formatit të përshkimeve të punës; dokumentacioni që materializon procedurën e ristrukturimit; aktet administrative që materializojnë vendimmarrjen e Komisionit të Ristrukturimit dhe të Departamentit të Administratës Publike; si dhe çdo dokumentacion tjetër që ndihmon realizimin e verifikimit të procesit.

### **I. Përmbajtja e Raportit**

Me miratimin e përbërjes së Këshillit të Ministrave, që përkon me mbarimin e procesit zgjedhor të vitit 2017, është riorganizuar i gjithë aparati shtetëror dhe gjatë këtij procesi janë shkruar 8 ministri të mëparshme, funksionet e të cilave i janë bashkuan 11 ministrive të mbetura, si dhe u shtuan 2 ministri të reja, duke e reduktuar numrin nga 19 ministri, që ishin para zgjedhjeve, në 13 ministri.

Për pasojë, Ministria e Drejtësisë, e cila është subjekt i këtij monitorimi, si dhe gjithë ministrinë e tjera, kaluan në proces rristrukturimi.

Në përfundim të procesit të monitorimit rezultoi si më poshtë:

## **II. Analiza e Procesit të Rristrukturimit**

Me konstituimin e përbërjes së Këshillit të Ministrave, pas procesit zgjedhor (Qershor, viti 2017), u miratuan nga ky i fundit dhe aktet nënligjore për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë së ministrive të linjës.

Për Ministrinë e Drejtësisë, e cila është objekt i kësaj mbikëqyrje, ka dalë Vendimi nr. 506, datë 13.09.2017, i Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Drejtësisë”.

Më tej, me Urdhrin nr. 166, datë 05.10.2017, të Kryeministrit “Për Miratimin e strukturës dhe të organikës së Ministrisë së Drejtësisë”, të ndryshuar, me Urdhrin nr. 238 datë 13.12.2017 “Për disa ndryshime në Urdhrin nr. 166, datë 10.05.2017”, është miratuar struktura dhe organika e re, sipas skemës 1 e 2, bashkëlidhur këtij urdhri.

### **I. *Analiza e ndryshimeve të strukturës organizative***

#### **➤ *Struktura dhe organika e mëparshme e Ministrisë së Drejtësisë***

Nga krahasimi i strukturës aktuale me strukturën organizative të mëparshme, rezulton se, institucioni është riorganizuar duke ndryshuar rrënjësisht mënyrën e organizimit strukturor të njërive të tij organizative (*Drejtorive të Përgjithshme, Drejtorive dhe Sektorëve*), e cila është pasuar me ndryshim të skemës organizative, të hierarkisë e llogaridhënies, të emërtesave, të përbërjes dhe të nivelit të kategorive të pagës të pozicioneve të punës, situatë e cila paraqitet në mënyrë të detajuar si më poshtë:

Ky institucion, para miratimit të strukturës aktuale funksiononte mbi bazën e strukturës dhe organikës së miratuar me urdhrin nr. 76, datë 28.04.2016, të Kryeministrit, “Për miratimin e strukturës dhe organikës së Ministrisë së Drejtësisë”. Sipas kësaj strukture, konstatohet se, institucioni në fjalë, ka pasur **135** pozicione pune, prej të cilave, **104** ishin pjesë e shërbimit civil.

Duke vlerësuar klasifikimin e pozicioneve në shërbimin civil, sipas përcaktimeve të nenit 19, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar dhe vendimit nr. 142, datë 13.02.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura”, i ndryshuar, **104** pozicionet e punës pjesë e shërbimit civil, në strukturën paraardhëse të Ministrisë së Drejtësisë, paraqiten si më poshtë:

- Nëpunës civilë të nivelit të lartë drejtues, **4** pozicione pune ose 4% të pozicioneve të punës pjesë e shërbimit civil, të cila i përkasin pozicioneve:
  - 1 “Sekretar i Përgjithshëm” – kategoria e pagës I-a;
  - 3 “Drejtor i Përgjithshëm” – kategoria e pagës II-a.
- Nëpunës civilë të nivelit të mesëm drejtues, **10** pozicione pune, ose 10 % të pozicioneve të punës pjesë e shërbimit civil, të cilat i përkasin pozicionit “Drejtor Drejtorie” – kategoria e pagës II-b;
- Nëpunës civilë të nivelit të ulët drejtues, **41** pozicione pune, ose 39 % të pozicioneve të punës pjesë e shërbimit civil, të cilat i përkasin:
  - 16 “Përgjegjës Sektori” - kategoria e pagës III-a;
  - 3 “Përgjegjës Sektori” – kategoria e pagës III-a/1;
  - 22 “Inspektor” – kategoria e pagës III-a
- Nëpunës civilë të nivelit ekzekutiv, **49** pozicione pune, ose 47 % të pozicioneve të punës pjesë e shërbimit civil, nga të cilat i përkasin pozicioneve:
  - 1 “Specialist redaktor” – kategoria e pagës III-a;
  - 42 “Specialist/kategoria e pagës III-b”;
  - 3 “Specialist/kategoria e pagës IV-a”
  - 3 “Specialist/kategoria e pagës IV-b”.

➤ **Struktura dhe organika aktuale e Ministrisë së Drejtësisë**

Struktura dhe organika e Ministrisë së Drejtësisë, miratuar me urdhrin nr. 166, datë 05.10.2017, të Kryeministrit, “Për miratimin e strukturës dhe organikës së Ministrisë së Drejtësisë”, parashikonte **146** pozicione pune gjithsej, nga të cilat:

- **3** pozicione pune, janë funksione politike;
- **9** pozicione pune, janë funksionar kabinetit;
- **15** pozicione pune, janë punonjës administrativ (*mbështetës*);
- **119** pozicione pune janë pjesë e shërbimit civil.

Ndërkohë, rezulton se me urdhrin nr. 238, datë 13.12.2017, të Kryeministrit, “Për disa ndryshime dhe shtesa ne urdhrin nr. 166, datë 05.10.2017, të Kryeministrit, “Për miratimin e strukturës dhe organikës së Ministrisë së Drejtësisë”, struktura dhe organika e Ministrisë së Drejtësisë ka pësuar ndryshim duke parashikuar **149** pozicione pune.

Nga këqyrja e strukturës dhe organikës së institucionit të mbikëqyrur, konstatohet se nuk ka ndryshim të numrit të pozicioneve të shërbimit civil, por shtim të numrit të funksionarëve të kabinetit (*shtuar 2 pozicione këshilltar*) dhe të numrit të punonjësve administrativ (*shtuar 1 pozicion magazinier*).

Duke vlerësuar klasifikimin e pozicioneve në shërbimin civil, në përputhje me përcaktimet e nenit 19, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe vendimin nr. 142, datë 12.03.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura”, i

ndryshuar, **119** pozicionet e punës pjesë e shërbimit civil në Ministrinë e Drejtësisë, ndahen si më poshtë:

- Nëpunës civilë të nivelit të lartë drejtues janë **5** pozicione pune, ose 5 % të pozicioneve të punës pjesë e shërbimit civil, të cilat i përkasin pozicioneve:
  - 1 “Sekretar i Përgjithshëm”;
  - 4 “Drejtor i Përgjithshëm”;
- Nëpunës civilë të nivelit të mesëm drejtues, janë **11** pozicione pune, ose 10 % të pozicioneve të punës pjesë e shërbimit civil, të cilat i përkasin pozicionit “Drejtor Drejtorie”;
- Nëpunës civilë të nivelit të ulët drejtues, janë **28** pozicione pune, ose 24 % të pozicioneve të punës pjesë e shërbimit civil, të cilat i përkasin pozicioneve:
  - 27 “Përgjegjës Sektori” – kategoria e pagës III-a;
  - 1 “Përgjegjës Sektori” – kategoria e pagës III-a/1
- Nëpunës civilë të nivelit ekzekutiv, janë **75** pozicione pune, ose 61 % të pozicioneve të punës pjesë e shërbimit civil, të cilat i përkasin pozicioneve:
  - 66 “Specialist” – kategoria e pagës III-b;
  - 5 “Specialist” – kategoria e pagës IV-a;
  - 4 “Specialist” – kategoria e pagës IV-b.

Mënyra e organizimit të pozicioneve të shërbimit civil sipas strukturës aktuale krahasuar me strukturën e mëparshme të Ministrisë së Drejtësisë, paraqitet si më poshtë:

***Tabela nr. 1: Pozicionet e shërbimit civil sipas strukturës së mëparshme dhe strukturës aktuale***

Pozicionet e shërbimit civil sipas kategorisë	Pozicionet e shërbimit civil sipas emërtesës	Numri i pozicioneve Struktura e mëparshme		Numri i pozicioneve Struktura aktuale	
		Sipas emërtesës	Sipas kategorisë	Sipas emërtesës	Sipas kategorisë
TND	Sekretar i Përgjithshëm	1	4	1	5
	Drejtor i Përgjithshëm	3		4	
Niveli i mesëm drejtues	Drejtor Drejtorie	10	10	11	11
Niveli i ulët drejtues	Përgjegjës Sektori III-a	16	41	27	28
	Përgjegjës Sektori III-a/1	3		1	
	Inspektor III-a	22		-	
Niveli ekzekutiv	Specialist redaktor III-a	1	49	1 (III-b)	75
	Specialist III-b	42		65	
	Specialist IV- a	3		5	
	Specialist IV-b	3		4	
Pozicione të shërbimit civil në total		<b>104</b>		<b>119</b>	

Për sa më sipër, konstatohet se, në kuadër të ristrukturimit, institucioni është përfshirë në një proces riorganizimi, për arsye se:

- Është shtuar numri i përgjithshëm i njëjësive organizative me emërtesën Drejtori e Përgjithshme. Struktura dhe organika aktuale e Ministrisë së drejtësisë është e

- organizuar në 5 Drejtori të Përgjithshme, ndërkohë që struktura e mëparshme ka qenë e organizuar në 4 njësi organizative me emërtesën “Drejtori e Përgjithshme”;
- Është shtuar numri i përgjithshëm i drejtorëve, pasi sipas strukturës aktuale numri i drejtorëve është 11, ndërkohë që në strukturën e mëparshme evidentohen 10 pozicione të nivelit të mesëm drejtues;
  - Është shtuar numri i përgjithshëm i njësive organizative me emërtesën “Sektor”, pasi sipas strukturës aktuale numri i tyre është 28, ndërkohë që në strukturën e mëparshme ka pasur 19 njësi organizative me emërtesën “Sektor”;
  - Janë suprimuar plotësisht pozicionet e punës me emërtesën “Inspektor” – kategoria III-a, të cilat nga institucioni i Ministrisë së Drejtësisë, Komisioni i Ristrukturimit dhe DAP, janë konsideruar si pozicione të nivelit të ulët drejtues, për shkak të funksioneve që ata kryenin;
  - Është shtuar numri i përgjithshëm i pozicioneve të nivelit ekzekutiv me emërtesën “Specialist”, pasi sipas strukturës aktuale numri i specialistëve në total është 75, ndërkohë që në strukturën e mëparshme evidentohen 49 pozicione të tilla;
  - Pozicioni “Specialist redaktor”, është kategorizuar në nivelin e pagës III-b, ndërkohë që sipas strukturës së mëparshme ka qenë me kategori page III-a.

Komisioneri arrin në konkluzionin se, miratimi i strukturës së Ministrisë së Drejtësisë, është shoqëruar me ristrukturim të institucionit, pasi konstatohet suprimim dhe shtim i pozicione të punës pjesë e shërbimit civil si dhe riorganizimi i njësive organizative të pozicionit të punës.

### **III. Procedurat e ndjekura në kuadër të ristrukturimit të Ministrisë së Drejtësisë**

Baza ligjore mbi të cilat duhet të bëhet vlerësimi i ligjshmërisë së procesit të transferimit të përhershëm të nëpunësve civilë, në një pozicion tjetër të shërbimit civil, në rastin e mbylljes dhe ristrukturimit të institucionit, janë përcaktimet e nenit 50, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, Kreu II, i vendimit nr. 125, datë 17.02.2016, i Këshillit të Ministrave, “Për transferimin e përkohshëm dhe të përhershëm të nëpunësve civilë”, si dhe të Udhëzimit nr. 1, datë 01.03.2016, të Departamentit të Administratës Publike, “Për krijimin, funksionimin dhe kompetencat e Komisionit të Ristrukturimit për shkak të mbylljes apo ristrukturimit të institucionit”.

Departamenti i Administratës Publike, në cilësinë e njësive përgjegjëse për këtë rast, është subjekti i cili drejton të gjithë procesin e ristrukturimit, duke respektuar të gjitha etapat që kërkon ky proces. Nga dokumentacioni i administruar gjatë procesit të verifikimit të ligjshmërisë së procesit të ristrukturimit të Ministrisë së Drejtësisë, rezultojnë të jenë marrë masat si më poshtë:

#### ***a) Njoftimi për fillimin e procedurës së ristrukturimit***

Në zbatim të pikës 7, të nenit 50, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, dhe pikës 15, të vendimit nr. 125, datë 17.02.2016, të Këshillit të Ministrave, “Për transferimin e përkohshëm dhe të përhershëm të nëpunësve civilë”, rezulton se njësia



përgjegjëse, DAP, ka njoftuar individualisht nëpunësit civilë, për fillimin e procedurës së ristrukturimit. Rezulton se këto akte, i janë njoftuar nëpunësve civilë në datën 13.09.2017.

#### ***b) Komisioni i Ristrukturimit***

Me miratimin dhe hyrjen në fuqi të strukturës dhe organikës së re, të institucionit të mbikëqyrur, njësia përgjegjëse ka krijuar Komisionin e Ristrukturimit me urdhrin nr. 100/2, datë 10.10.2017, *“Për krijimin e Komisionit të Ristrukturimit në kuadër të ristrukturimit të Ministrisë së Drejtësisë”*, me përbërje si vijon:

- ✓ \*\*\*\*\* , *Specialiste në Sektorin e Performancës dhe Programeve Trajnuese, në Drejtorinë e Zhvillimit të Institucioneve të Pagave, në Departamentin e Administratës Publike – Kryetar;*
- ✓ \*\*\*\*\* , *Sekretar i Përgjithshëm i Ministrisë së Drejtësisë – anëtar. Emëruar në këtë pozicion me aktin nr. 5930/1 prot., datë 06.10.2017, të Departamentit të Administratës Publike, “Emërim në një pozicion të rregullt të TND-së”;*
- ✓ \*\*\*\*\* , *Drejtor i Përgjithshëm, në Drejtorinë e Përgjithshme të Kodifikimit – anëtar. Emëruar në këtë pozicion me aktin nr. 6353/2, datë 07.11.2017, të Departamentit të Administratës Publike, “Lirimi nga një pozicion i rregullt drejtues dhe emërim në një pozicion të rregullt drejtues, të anëtarit të TND-së”.*

Konstatohet se në këtë rast është vepruar në përputhje me Udhëzimin nr. 1, datë 01.03.2016, të Departamentit të Administratës Publike, *“Për krijimin, funksionimin, përbërjen dhe kompetencat e Komisionit të Ristrukturimit për shkak të mbylljes apo ristrukturimit të institucionit”*, ku në pikën 2, germa “a” të tij, përcakton se, Komisioni i Ristrukturimit, duhet të përbëhet nga:

- Nëpunësi më i lartë civil i ministrisë që po ristrukturohet;
- Drejtuesi i njësisë ku bën pjesë menaxhimi i burimeve njerëzore në ministrinë që po ristrukturohet;
- Një përfaqësues nga njësia përgjegjëse (DAP).

Nga dokumentacioni i administruar rezulton se, pas miratimit të strukturës dhe organikës së Ministrisë së Drejtësisë, pozicioni i drejtuesit të njësisë, ku bën pjesë njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore, ka qenë pozicion vakant. Kjo për faktin se nëpunësi \*\*\*\*\* , i emëruar në pozicionin *“Drejtor i Përgjithshëm i Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve Mbështetëse”*, në cilësinë e anëtarit të trupës së nivelit të lartë drejtues, me aktin nr. 6353/1 prot., datë 07.11.2017, është liruar nga ky pozicion dhe është regjistruar në *“Listën e anëtarëve të TND-së në pritje për t’u caktuar në një pozicion të rregullt”*.

Në këto kushte, për krijimin e Komisionit të Ristrukturimit, njësia përgjegjëse (DAP), nga radhët e ministrisë së Drejtësisë, ka zgjedhur si anëtarë nëpunësin më të lartë civil, konkretisht nëpunësen \*\*\*\*\*.

Për sa më sipër, Komisioneri vlerëson se njësia përgjegjëse ka vepruar drejt në krijimin e Komisionit të Ristrukturimit.



### c) *Përshkrimet e punës*

Në kuptim të nenit 50, të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar dhe Kreut II, të vendimit nr. 125, datë 17.02.2016, të Këshillit të Ministrave, “*Për transferimin e përkohshëm dhe të përhershëm të nëpunësve civilë*”, procedura Komisionit të Ristrukturimit për shqyrtimin e mundësisë së sistemimit apo transferimit të përhershëm të nëpunësve civilë, në vendet e lira apo të reja të krijuara si pasojë ristrukturimit të institucionit, mbështetet në analizën e kriterëve specifike të pozicionit të punës dhe të dhënave të nëpunësve civilë.

Kërkesat e përgjithshme dhe të veçanta për çdo pozicion pune në shërbimin civil, në zbatim të Kreut IV, pika 13, germa “ç”, të vendimit nr. 142, datë 13.02.2014, të Këshillit të Ministrave, “*Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura*”, i ndryshuar, përcaktohen tek përshkrimet e punës.

Sipas përcaktimeve të pikës 14, të Kreut IV “*Procedura dhe formati i përshkrimit të punës*”, të Vendimit nr. 142, datë 12.03.2014, të Këshillit të Ministrave, “*Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura*”, i ndryshuar, përshkrimet e punës hartohen kur krijohen institucione të reja, kur ndryshon mënyra e organizimit të institucionit apo kur kanë ndodhur ndryshime ose miratime të legjislacionit specifik mbi bazën e të cilit funksionon institucioni.

Në vijim të kësaj analize, bazuar në pikën 8, paragrafi “*Hapi 2*”, të Udhëzimit nr. 1, datë 01.03.2016, “*Për krijimin, funksionin dhe kompetencat e Komisionit të Ristrukturimit për shkak të mbylljes apo ristrukturimit të institucionit*”, të Departamentit të Administratës Publike, Komisioni i Ristrukturimit përpara se të marrë vendimin përfundimtar për sistemimin e punonjësve të prekur nga ristrukturimi, duhet të verifikojë përshkrimet e punës për të evidentuar kriteret e veçanta për secilin pozicion dhe pastaj “*Hapi 3*”, të verifikojë dosjet personale të nëpunësve civilë, në mënyrë që të dalë me një konkluzion objektiv në lidhje me përputhshmërinë e kriterëve të veçanta që kërkohen nga pozicioni i punës, me kriteret e veçanta që gëzon nëpunësi civil.

Në rastin konkret, administrata e institucionit të mbikëqyrur, me urdhrin nr. 166, datë 05.10.2017, të Kryeministrit, “*Për miratimin e strukturës dhe organikës së Ministrisë së Drejtësisë*”, ka kaluar në proces ristrukturimi. Në këto kushte, dhe në referencë të dispozitave të mësipërme, përcaktohet se procesi i ristrukturimit të Ministrisë së Drejtësisë duhej të paraprihej nga hartimi i përshkrimeve të reja të punës.

Për arsyet e përmendura më lart, u verifikuan përshkrimet e punës për të gjitha pozicionet e punës pjesë e shërbimit civil. Nga verifikimi i dokumentacionit të administruar, rezulton se, në momentin e ristrukturimit të Ministrisë së Drejtësisë, formularët e përshkrimit të punës nuk kanë qenë të përfunduar.

Në këto kushte, në momentin e realizimit të procesit të ristrukturimit, Komisioni i Ristrukturimit, në marrjen e vendimit përfundimtar për sistemimin e nëpunësve, është mjaftuar me informacionin që përmbanin përshkrimet e punës të hartuara në mënyrë të pjesshme. Kjo

praktikë pune, vlerësohet si parregullsi në administrimin e shërbimit civil, për arsye se ligji specifik që rregullon këtë aspekt kërkon që procesi i hartimit të përshkrimeve të punës duhet të përfundojë përpara se të fillojë procesi ristrukturimit.

Por, nga ana tjetër, konstatohet se, në momentin e ristrukturimit janë përcaktuar kërkesat e posaçme për çdo pozicion pune, sipas kushteve të reja të krijuara, të cilat i kanë shërbyer Komisionit të Ristrukturimit për të vlerësuar përmbushjen e tyre nga punonjësit aktual.

Përshkrimet e reja të punës, duke vlerësuar kompleksitetin e procesit, kërkojnë një angazhim të madh nga nëpunësit përgjegjës të cilëve ligji iu ka ngarkuar detyrën për hartimin e tyre dhe miratimin e tyre.

Në kushtet kur në kuadër të ristrukturimit, eprori direkt nuk ishte sistemuar në pozicionin përkatës, kjo parregullsi nuk e cenon procesin edhe për faktin se kriteret e veçanta që kërkojnë për çdo pozicion pune pjesë e shërbimit civil, rezultojnë se ishin përcaktuar përpara se procesi i ristrukturimit të fillonte. Por, kjo problematikë është evidentuar nga Komisioneri, në mënyrë që në të ardhmen aktorët që marrin pjesë në këtë proces, të tregojnë kujdes lidhur me realizimin të gjitha procedurave që kërkon procesi i ristrukturimit.

Konstatohet se, aktualisht përshkrimet e punës janë përfunduar dhe nga përmbajtja e formularëve të verifikuar në subjekt, rezultojnë se në këto akte janë përfshirë elementët, sipas modelit standard të miratuar, si dhe të dhënat për pozicionin e punës, misionin, qëllimi i përgjithshëm i pozicionit të punës, detyrat kryesore, përgjegjësitë kryesore, zgjidhja e problemeve, vendimmarrja, mjedisi menaxherial, mbikëqyrja, stafi në varësi, kushtet e punës, si dhe është i nënshkruar nga subjektet e parashikuara nga ligji.

***d) Propozimi i Komisionit të Ristrukturimit për sistemimin e nëpunësve civilë, në kuadër të ristrukturimit të Ministrisë së Drejtësisë.***

Komisioni i Ristrukturimit, i ngritur nga njësi përgjegjëse, DAP, pasi ka analizuar strukturën dhe organikën e mëparshme dhe aktuale të Ministrisë së Drejtësisë, ka shqyrtuar mundësinë e sistemimit të çdo nëpunësi civil, në referencë të kriterëve të veçanta të pozicioneve të punës të ministrisë në fjalë.

Komisioni i Ristrukturimit për Ministrinë e Drejtësisë, në përfundim të kësaj procedure, ka propozuar transferimin e nëpunësve civilë, vendet e të cilëve janë prekur për shkak të ristrukturimit, proces i cili materializohet me vendimet si më poshtë:

- Vendimi nr. 6499 prot., datë 10.11.2017, i Komisionit të Ristrukturimit të Ministrisë së Drejtësisë për propozimin e transferimit të përhershëm të nëpunësve civilë, në kuadër të ristrukturimit;
- Vendimi nr. 6499/55 prot., datë 04.12.2017, i Komisionit të Ristrukturimit të Ministrisë së Drejtësisë për propozimin e transferimit të përhershëm të nëpunësve civilë, në kuadër të ristrukturimit;

Nga sa është parashtruar më sipër, rezultojnë se Ministria e Drejtësisë ka pasur **104** pozicione pune pjesë e shërbimit civil. Referuar listë pagesës dhe listë prezencës së muajit Shator 2017, rezultojnë se në këtë moment, kanë qenë në marrëdhënie pune **88** nëpunës civilë

gjithsej, (pasi **16** pozicione pune kanë qenë të lira) të cilët gjejnë pasqyrim në tabelën si më poshtë, sipas kategorive që ata i përkasin:

**Tabela nr. 2:** Paraqitja e pozicioneve të punës, plotësuar me nëpunës civil, në muaji shtator 2017.

Kategoria e pozicionit	Klasa e pozicionit	Ministria e Mjedisit
TND	Drejtor i Përgjithshëm	2
Nivel i mesëm drejtues	Drejtor Drejtorie	9
Nivel i ulët drejtues	Përgjegjës Sektori III-a	13
	Përgjegjës Sektori III-a/1	3
	Inspektor III-a	19
Nivel ekzekutiv	Specialist redaktor III-a	1
	Specialist III-b	39
	Specialist IV- a	2
Numri i nëpunësve civilë në marrëdhënie pune		<b>88</b>
Vende vakante		<b>16</b>
Totali i pozicioneve të shërbimit civil		<b>104</b>

➤ **Nëpunësit e kategorisë së nivelit të lartë drejtues (anëtarë TND)**

Në lidhje me nëpunësit civilë të kategorisë së nivelit të lartë drejtues (*anëtar TND*), vërehet se, këta nëpunës nuk janë përfshirë në procesin e ristrukturimit, kjo për shkak të regjimit dhe statusit të posaçëm që gëzojnë ata si anëtarë të TND-së. Në nenet 27 - 33, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe në Kreun VII, pika 3 dhe 5, të vendimit nr. 118, datë 05.03.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për procedurat e emërimit, rekrutimit, menaxhimit dhe përfundimit të marrëdhënies në shërbimin civil të nëpunësve të nivelit të lartë drejtues dhe anëtarëve të TND”, përcaktohet se, Departamenti i Administratës Publike, në cilësinë e njësisë përgjegjëse, është organi kompetent i cili bën emërimin dhe lirimimin e anëtarëve të TND-së, nga një pozicion i rregullt i nivelit të lartë drejtues.

Për sa më sipër, konstatohet se, Komisioni i Ristrukturimit i Ministrisë së Drejtësisë, me të drejtë, nuk ka trajtuar nëpunësit civilë \*\*\*\*\* dhe \*\*\*\*\*, të cilët janë anëtarë trupës së nivelit të lartë drejtues. Nga dokumentacioni i administruar, rezulton se njësi përgjegjëse, në kuadër të ristrukturimit të institucionit të mbikëqyrur, për punonjësit e mësipërm ka vepruar si më poshtë:

1. \*\*\*\*\* ka qenë e emëruar në pozicionin “Drejtor i Përgjithshëm”, në Drejtorinë e Përgjithshme të Kodifikimit, sipas strukturës së mëparshme të Ministrisë së Drejtësisë. Në zbatim të Kreut pika 3 dhe 5, të vendimit nr. 118, datë , datë 05.03.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për procedurat e emërimit, rekrutimit, menaxhimit dhe përfundimit të marrëdhënies në shërbimin civil të nëpunësve të nivelit të lartë drejtues dhe anëtarëve të TND”, Departamenti i Administratës Publike, me aktin nr. 6353/2 prot., datë 07.11.2017, ka vendosur lirimimin e kësaj nëpunëse nga pozicioni i mëparshëm dhe emërimin e saj në pozicionin e rregullt “Drejtor i Përgjithshëm i Drejtorisë së Përgjithshme Rregullatore e Çështjeve të Drejtësisë”.

2. \*\*\*\*\*\*, ka qenë i emëruar në pozicionin “*Drejtor i Përgjithshëm*”, në Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimeve Mbështetëse. Rezulton se, në kuadër të procesit të ristrukturimit, njësia përgjegjëse, me aktin nr. 6353/1 prot., datë 07.11.2017, ka vendosur lirimin e këtij nëpunësi nga pozicioni i mësipërm dhe regjistrimin e tij në “*Listën e anëtarëve të TND-së në pritje për t’u caktuar në një pozicion të rregullt*”. Më tej, në zbatim të Kreut VII, pika 3 dhe 5, të vendimit nr. 118, datë , datë 05.03.2014, të Këshillit të Ministrave, “*Për procedurat e emërimit, rekrutimit, menaxhimit dhe përfundimit të marrëdhënies në shërbimin civil të nëpunësve të nivelit të lartë drejtues dhe anëtarëve të TND*”, Departamenti i Administratës Publike, me aktin nr. 6479/1, datë 09.11.2017, ka vendosur emërimin e këtij nëpunësi në pozicionin e rregullt “*Drejtor i Përgjithshëm*”, në Drejtorinë e Përgjithshme Ekonomike dhe Shërbimeve Mbështetëse.

➤ **Nëpunësit civilë të nivelit të mesëm e të ulët drejtues dhe të nivelit ekzekutiv.**

Për sa u arsyetua më sipër, rezulton se numri i nëpunësve civilë, të emëruar në pozicione të nivelit të mesëm e të ulët drejtues dhe të nivelit ekzekutiv, pozicionet e të cilëve janë prekur nga procesi i ristrukturimit, është **86** nëpunës civilë.

Nga dokumentacioni i administruar, rezulton se, Komisioni i ristrukturimit, në vendimet për propozimin e transferimit të përhershëm të nëpunësve civilë, ka shqyrtuar dhe trajtuar mundësinë e transferimit vetëm për **83**, prej tyre, duke përjashtuar nga ky proces **3** nëpunës civilë. (*Bëhet fjalë për nëpunësit Denisa Asko, Ylli Bedalli dhe Leonard Filopati, rasti i të cilëve do të trajtohet me poshtë*).

Duke vlerësuar propozimet e bëra për **80** nëpunës civilë, konstatohet se:

- në **70** raste, është propozuar transferimi i tyre në një vend të lirë ekzistues, brenda organikës së institucionit të Ministrisë së Drejtësisë;
- në **2** raste, nëpërmjet Departamentit të Administratës Publike, është propozuar transferimi i tyre në një vend të lirë ekzistues, në një institucion tjetër të shërbimit civil;
- në **11** raste, është propozuar lirimi nga shërbimi civil.

Procedura e Komisionit të Ristrukturimit, për propozimin e transferimit të përhershëm të nëpunësve civilë, në kuptim të nenit 50, të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, të ndryshuar, kërkon plotësimin e dy kushteve themelore:

- a) pozicioni i mëparshëm të mos ekzistojë më, çka nënkupton që të jetë suprimuar, shkurtuar ose riorganizuar;
- b) nëpunësi civil, pozicioni i të cilit preket nga ristrukturimi, duhet të transferohet në një pozicion tjetër të shërbimit civil.

Komisioni i Ristrukturimit, në referencë të dispozitës së mësipërme dhe të përcaktimeve të Udhëzimit nr. 1, datë 01.03.2016, të Departamentit të Administratës Publike, “*Për krijimin, funksionimin dhe kompetencat e Komisionit të Ristrukturimit për shkak të mbylljes apo ristrukturimit të institucionit*”, i ndryshuar, ka për detyrë të analizojë përshkrimet e punës së pozicioneve të ristrukturuar, ndryshimin e kriterëve specifike, si dhe dosjen personale të

nëpunësve në pritje të transferimit, duke evidentuar elementët thelbësorë mbi të cilët do të bazohet vendimmarrja, të cilat janë përvoja, arsimi dhe vlerësimi i arritjeve.

Në përfundim të kësaj analize, Komisioni i Ristrukturimit propozon transferimin e nëpunësve civilë në pozicionet e lira, në përputhje me strukturën aktuale të institucionit në ristrukturim. Vetëm në rastet e pamundësisë së transferimit të nëpunësve civilë në pozicionet që i përkasin të njëjtit sistem ministror ku nëpunësi ka qenë i emëruar, Komisioni propozon transferimin e nëpunësit në një pozicion të lirë në një institucion tjetër të shërbimit civil, me kushtin që transferimi të kryhet në një pozicion të së njëjtës kategori.

Me qëllim verifikimin e ligjshmërisë së veprimeve administrative të kryera nga Komisioni i Ristrukturimit, në kuadër të riorganizimit të Ministrisë së Drejtësisë, u analizua dokumentacioni përkatës dhe nisur nga mënyra se si ka vepruar ky mekanizëm, është paraqitur i grupuar në vijim:

*e) Rastet e propozimit për sistemim në pozicionet e lira ekzistuese, brenda organikës së Ministrisë së Drejtësisë.*

Nga dokumentacioni i administruar, rezulton se Komisioni i Ristrukturimit, në **70** raste, ka propozuar transferimin e përhershëm të nëpunësve civilë në pozicionet e lira, sipas strukturës aktuale të Ministrisë së Drejtësisë.

o *Niveli i mesëm drejtues*

- ✓ Për **4** nëpunës të nivelit të mesëm drejtues – kategoria II-b, është propozuar transferimi në pozicione pune të nivelit të mesëm drejtues – kategoria II-b. (*Bëhet fjalë për nëpunësit \*\*\*\*\**, \*\*\*\*\**, \*\*\*\*\* dhe \*\*\*\*\**)

Komisioneri konstaton se për **4** nëpunësit e mësipërm, Komisioni i Ristrukturimit ka vepruar në përputhje me përcaktimet e nenit 50, pika 1, të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, duke propozuar transferimin e tyre në pozicione të shërbimit civil të së njëjtës kategori.

o *Niveli i ulët drejtues*

- ✓ Për **9** nëpunës të nivelit të ulët drejtues “*Përgjegjës Sektor*” – kategoria III-a, është propozuar transferimi në një pozicion të nivelit të ulët drejtues “*Përgjegjës Sektor*” – kategoria III-a. (*Bëhet fjalë për nëpunësit \*\*\*\*\**, \*\*\*\*\**, \*\*\*\*\**, \*\*\*\*\**, \*\*\*\*\**, \*\*\*\*\**, \*\*\*\*\* dhe \*\*\*\*\**);
- ✓ Për **1** punonjës të nivelit të ulët drejtues “*Përgjegjës Sektor*” – kategoria III-a/1, është propozuar transferimi në një pozicione të nivelit të ulët drejtues “*Përgjegjës Sektor*” – kategoria III-a/1. (*Bëhet fjalë për nëpunësin \*\*\*\*\**);
- ✓ Për **2** punonjës të nivelit të ulët drejtues “*Përgjegjës Sektor*” – kategoria III-a/1, është propozuar transferimi në një pozicione të nivelit të ulët drejtues “*Përgjegjës*”

*Sektorit*” – kategoria III-a. (Bëhet fjalë për nëpunësit \*\*\*\*\* dhe \*\*\*\*\*);

- ✓ Për 4 punonjës të nivelit të ulët drejtues “Inspektor” – kategoria III-a, është propozuar transferimi në një pozicione të nivelit të ulët drejtues “Përgjegjës Sektorit” – kategoria III-a. (Bëhet fjalë për nëpunësit \*\*\*\*\* , \*\*\*\*\* , \*\*\*\*\* dhe \*\*\*\*\*).

Komisioneri e vlerëson të rregullt propozimin e Komisionit të Ristrukturimit për transferimin e këtyre nëpunësve në pozicione të shërbimit civil të së njëjtës kategori, pavarësisht se në 2 raste, konstatohet ndryshimi i kategorisë së pagës.

Në kuptim të Lidhjes nr. 4, të vendimit nr. 187, datë 08.03.2017, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nëpunësve civilë/nëpunësve, zëvendësministrit dhe të nëpunësve të kabineteve, në kryeministri, aparatet e ministrive të linjës, administratën e presidentit, Kuvendit, Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Gjykatën e Lartë, Prokurorinë e Përgjithshme, disa institucione të pavarura, institucionet në varësi të Kryeministrit, institucionet në varësi të ministrave të linjës dhe Administratën e Prefektit”, i ndryshuar, kategoritë e pagës III-a dhe III-a/1, i përkasin pozicioneve të kategorisë së tretë të shërbimit civil, me emërtesën “Përgjegjës Sektorit” ose çdo pozicion i barasvlershëm me të. Pra, në këto raste është respektuar kërkesa e ligjit për ruajtjen e të njëjtës kategori të shërbimit civil, gjatë transferimeve për shkak ristrukturimi.

- ✓ Për 1 nëpunës të nivelit të ulët drejtues “Përgjegjës Sektorit” – kategoria III-a, është propozuar transferimi në një pozicion të nivelit ekzekutiv “Specialist”, kategoria III-b. (Bëhet fjalë për nëpunësin \*\*\*\*\*);
- ✓ Për 8 punonjës të nivelit të ulët drejtues “Inspektor”, - kategoria III-a, është propozuar transferimi në një pozicione të nivelit ekzekutiv “Specialist”, kategoria III-b. (Bëhet fjalë për nëpunësit \*\*\*\*\* , \*\*\*\*\* , \*\*\*\*\* , \*\*\*\*\* , \*\*\*\*\* dhe \*\*\*\*\*).

Në lidhje me punonjësit e mësipërm, propozimi i transferimit të tyre në një pozicion civil të një niveli më të ulët, ka ardhur si rezultat i shkrirjes dhe mos ekzistencës së pozicioneve të mëparshme, ku ata kanë qenë të emëruar, në strukturën aktuale të Ministrisë së Drejtësisë. Komisioni i Ristrukturimit, për shkak të pamundësisë së sistemimit të këtyre nëpunësve në pozicione të nivelit të ulët drejtues, bazuar në arsimin dhe përvojën e këtyre nëpunësve, ka propozuar transferimin e tyre, në pozicione të nivelit ekzekutiv, me emërtesën “Specialist”- kategoria e pagës III-b.

Nga verifikimi i dokumentacionit të administruar, rezulton se të 9 nëpunësit e mësipërm, kanë shprehur miratimin e tyre për transferimin në këto pozicione, fakt që materializohet në procesverbalet respektive, të cilat mbajnë datën 17.11.2017.

○ **Niveli ekzekutiv (Specialistët)**

- ✓ Për 35 nëpunës të nivelit ekzekutiv – kategoria III-b, është propozuar transferimi në pozicion të nivelit ekzekutiv – kategoria III-b. (Bëhet fjalë për nëpunësit



\*\*\*\*\* , \*\*\*\*\* , \*\*\*\*\* , \*\*\*\*\* , \*\*\*\*\* , \*\*\*\*\* ,  
\*\*\*\*\* , \*\*\*\*\* , \*\*\*\*\* , \*\*\*\*\* , \*\*\*\*\* , \*\*\*\*\* ,  
\*\*\*\*\* , \*\*\*\*\* , \*\*\*\*\* , \*\*\*\*\* , \*\*\*\*\* , \*\*\*\*\* ,  
\*\*\*\*\* , \*\*\*\*\* , \*\*\*\*\* , \*\*\*\*\* , \*\*\*\*\* , \*\*\*\*\* ,  
\*\*\*\*\* , \*\*\*\*\* , \*\*\*\*\* , \*\*\*\*\* , \*\*\*\*\* , \*\*\*\*\* ,  
\*\*\*\*\* , \*\*\*\*\* , \*\*\*\*\* , \*\*\*\*\* , \*\*\*\*\* dhe \*\*\*\*\*);

- ✓ Për 1 nëpunës të nivelit ekzekutiv– kategoria III-b, është propozuar transferimi në pozicion të nivelit ekzekutiv – IV-a. (Bëhet fjalë për nëpunësin \*\*\*\*\*);
- ✓ Për 2 nëpunës të nivelit ekzekutiv– kategoria IV-a, është propozuar transferimi në pozicion të nivelit ekzekutiv – IV-a. (Bëhet fjalë për nëpunësit \*\*\*\*\* dhe \*\*\*\*\*).
- ✓ Për 1 nëpunës të nivelit ekzekutiv “*Specialist redaktor*” – kategoria III-b, është propozuar transferimi në pozicion të nivelit ekzekutiv – kategoria III-b. (Bëhet fjalë për nëpunësin \*\*\*\*\*).

Komisioneri konstaton se për gjithë rastet e nëpunësve të mësipërm, Komisioni i Ristrukturimit ka vepruar në përputhje me përcaktimet e nenit 50, pika 1, të ligjit për nëpunësin civil, duke propozuar transferimin e tyre në pozicione të shërbimit civil të së njëjtës kategori. Në 2 raste, evidentohet ndryshim i kategorisë së pagës për nëpunësit e transferuar, por në kuptim të lidhjes nr. 4, të VKM nr. 187, datë 08.03.2017, pozicionet e punës me kategori page III-b, IV-a dhe IV-b, klasifikohen si pozicione të të njëjtës kategori në shërbimin civil, në nivelin ekzekutiv.

**f) Rastet e propozimit për sistemim në pozicionet e lira, jashtë organikës së Ministrisë së Drejtësisë, në institucione në shërbimin civil.**

Neni 50, i ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, në pikën 2, germa “ç”, përcakton se, në rastet e mbylljes apo rristrukturimit të institucionit, nëse nuk ekziston mundësia e transferimit të nëpunësit civil në pozicionet e institucionit që rristrukturohet, nëpunësi mund të transferohet në një institucion tjetër të shërbimit civil.

Nga verifikimi i dokumentacionit të administruar rezulton se, në 2 raste, Komisioni i Ristrukturimit, për nëpunësit pozicionet e të cilëve janë prekur nga rristrukturimi i Ministrisë së Drejtësisë, ka propozuar transferimin e tyre në institucione të tjera të shërbimit civil. Bëhet fjalë për nëpunësit:

1. \*\*\*\*\* , i cili ka qenë i emëruar në pozicionin Drejtor, i Drejtorisë së Shërbimeve Mbështetëse, në Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimeve Mbështetëse, në Ministrinë e Drejtësisë – kategoria II-b. Komisioni i Ristrukturimit me vendimin nr. 6499/55 prot., datë 04.12.2017, për këtë nëpunës ka propozuar transferimin në pozicionin “*Drejtor*”, në Drejtorinë e Mbikëqyrjes Elektronike, në Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimit të Provës – kategoria III-a;
2. \*\*\*\*\* , e cila ka qenë e emëruar në pozicionin “*Inspektor*”, në Sektorin e Inspektimit dhe Organizimit Gjyqësor, në Drejtorinë e Inspektimit Gjyqësor dhe



Prokurorisë, në Drejtorinë e Përgjithshme të Planifikimit Strategjik dhe Inspektimit të Çështjeve të Drejtësisë – kategoria III-a. Komisioni i Ristrukturimit me vendimin nr. 6499/55 prot., datë 04.12.2017, për këtë nëpunëse ka propozuar transferimin në pozicionin “Përgjegjës Sektori”, në Sektorin e Programimit, Hartimit dhe Harmonizimit të Akteve Rregullatore, në Drejtorinë e Programimit, Standardizimit dhe Harmonizimit të Kuadrit Rregullator, në Drejtorinë e Përgjithshme Rregullatore dhe Përputhshmërisë në Turizëm dhe Mjedis, në Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit – kategori III-a.

***g) Rastet e nëpunësve civilë, që nuk janë marrë në shqyrtim nga Komisioni i Ristrukturimit.***

Në referencë të listëpagesës dhe listëprezencës së muajit Shtator 2017, konstatohen **3** raste kur punonjësit, të cilët në momentin e miratimit të strukturës së re të Ministrisë së Drejtësisë kanë qenë të emëruar në pozicione të shërbimit civil, nuk janë marrë në shqyrtim nga Komisioni i Ristrukturimit. Duke analizuar në veçanti këto raste, rezulton si më poshtë:

- Punonjësja \*\*\*\*\*\*, ka qenë e emëruar në pozicionin “*Inspektor*”, në Sektorin e Inspektimit të Prokurorisë, në Drejtorinë e Inspektimit Gjyqësor dhe Prokurorisë, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Planifikimit Strategjik dhe Inspektimit të Çështjeve të Drejtësisë – kategoria III-a. Me urdhrin nr. 5869/6, datë 24.11.2017, të Ministrit të Drejtësisë, “*Për lirim dhe emërim në detyrë*”, kjo punonjëse është emëruar në pozicionin Përgjegjës Sektori, në Sektorin e Marrëdhënieve për Çështjet e Drejtësisë në Fushën Penale, në Drejtorinë Rregullatore për Çështjet e Drejtësisë, pranë Drejtorisë së Përgjithshme Rregullatore të Çështjeve të Drejtësisë – kategoria III-a.
- Punonjësi \*\*\*\*\*\*, ka qenë i emëruar në pozicionin “*Inspektor*”, në Sektorin e Inspektimit të Prokurorisë, në Drejtorinë e Inspektimit Gjyqësor dhe Prokurorisë, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Planifikimit Strategjik dhe Inspektimit të Çështjeve të Drejtësisë – kategoria III-a. Me urdhrin nr. 7172, datë 24.11.2017, të Ministrit të Drejtësisë, “*Për lirim dhe emërim në detyrë*”, ky punonjës është emëruar në pozicionin “*Specialist*”, në Sektorin e Monitorimit të Institucioneve të Varësisë në Fushën Penale, në Drejtorinë e Derregullimit, Lejeve, Licensave dhe Monitorimit, pranë Drejtorisë së Përgjithshme Rregullatore të Çështjeve të Drejtësisë – kategoria III-a.
- Punonjësi \*\*\*\*\*\*, ka qenë i emëruar në pozicionin “*Inspektor*”, në Sektorin e Inspektimit të Prokurorisë, në Drejtorinë e Inspektimit Gjyqësor dhe Prokurorisë, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Planifikimit Strategjik dhe Inspektimit të Çështjeve të Drejtësisë – kategoria III-a. Me urdhrin nr. 5869/5, 24.11.2017, të Ministrit të Drejtësisë, “*Për lirim dhe emërim në detyrë*”, ky punonjës është emëruar në pozicionin “*Specialist*”, në Sektorin e Monitorimit të Institucioneve të Varësisë në Fushën Penale, në Drejtorinë e Derregullimit, Lejeve, Licensave dhe Monitorimit, pranë Drejtorisë së Përgjithshme Rregullatore të Çështjeve të Drejtësisë – kategoria III-a. Aktualisht, rezulton se, me urdhrin nr. 1697, datë

07.02.2018, të Ministrit të Drejtësisë, “Për lirim nga detyra”, ky punonjës është liruar nga kjo detyrë, për shkak të mbushjes së moshës për pension pleqërie.

Në nenin 3, të ligjit nr. 8678, datë 14.05.2001, “Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë”, i ndryshuar, përcaktohet se gjyqtarët dhe prokurorët mund të shërbejnë si këshilltar ligjorë, si dhe në nivele drejtuese ose ekzekutive të strukturave juridiko-profesionale të Ministrisë së Drejtësisë. Më tej, në pikën 4, të kësaj dispozitë, përcaktohet se:

*“Pranimi dhe emërimi i gjyqtarëve a prokurorëve bëhet pasi të jetë dhënë pëlqimi përkatësisht, nga Këshilli i Lartë i Drejtësisë ose Prokurori i Përgjithshëm, sipas kërkesës së Ministrisë së Drejtësisë. Për vendet vakante në nivelet drejtuese dhe ekzekutive të strukturave juridiko-funksionale të Ministrisë së Drejtësisë, pranimi dhe emërimi bëhet pa konkurs”.*

Në lidhje me sa më sipër dhe në referencë të dokumentacionit të administruar rezulton se, punonjësit \*\*\*\*\*, \*\*\*\*\* dhe \*\*\*\*\*, janë punonjës të cilët gëzojnë statusin e gjyqtarit/prokurorit dhe si rrjedhim janë të përjashtuar nga skema e shërbimit civil. Kjo përcakton se, pavarësisht se ata ushtrojnë detyrën në pozicione të shërbimit civil, Komisioni i Ristrukturimit, nuk është organi kompetent për të shqyrtuar mundësinë e sistemimit të tyre në pozicionet e lira sipas strukturës aktuale të Ministrisë së Drejtësisë.

Kjo është dhe arsyeja, përse këta punonjës nuk janë trajtuar në vendimet e Komisionit të Ristrukturimit, pasi sistemimi i tyre, në zbatim të ligjit nr. 8678, datë 14.05.2001, “Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë”, i ndryshuar, është kryer nga Ministri i Drejtësisë, pra rregullohet me një ligj të veçantë.

#### ***h) Transferimi i nëpunësve civilë nga njësia përgjegjëse, Departamenti i Administratës Publike.***

Vendimi nr. 125, datë 17.02.2016, i Këshillit të Ministrave, “Për transferimin e përkohshëm dhe të përhershëm të nëpunësve civilë”, në Kreun II, pika 20, përcakton se njësia përgjegjëse (DAP), brenda 10 ditëve nga data e marrjes së propozimit nga Komisioni i Ristrukturimit, pasi shqyrton aktet merr vendim për transferimin e nëpunësit civil. Në referencë të Udhëzimit nr. 1, datë 01.03.2016, të Departamentit të Administratës Publike, “Për krijimin, funksionimin dhe kompetencat e Komisionit të Ristrukturimit për shkak të mbylljes apo ristrukturimit të institucionit”, i ndryshuar, njësia përgjegjëse mund të vendosë kthimin e akteve kur vërteton parregullsi ligjore të dukshme, të cilat kanë ndikuar në mënyrë të drejtpërdrejtë në vendimmarrje.

Në përfundim të kësaj procedure, Departamenti i Administratës Publike, njofton njësinë e menaxhimit të burimeve njerëzore në lidhje me vendimmarrjen e saj, si dhe nëpunësit civilë, për aktet individuale të transferimit të përhershëm në kuadër të ristrukturimit. Më tej, në zbatim të Kreut II, pika 20, të aktit nënligjor të mësipërm, nëpunësi civil duhet të japë mendimin e tij me shkrim, brenda 5 ditëve nga data e marrjes së njoftimit, në lidhje me vendimin për sistemimin e tij në një pozicion tjetër të shërbimit civil.

Në lidhje me këtë moment procedural, pas administrimit dhe shqyrtimit të dokumentacionit përkatës, rezulton se:

- ✓ Bazuar në vendimin nr. 6499 prot., datë 10.11.2017, të Komisionit të Ristrukturimit, njësia përgjegjëse (DAP), me vendimin nr. 6499/1, datë 10.11.2017, ka vendosur transferimin e përhershëm për **53** nëpunës civilë.
- ✓ Bazuar në vendimin nr. 6499/55 prot., datë 04.12.2017, të Komisionit të Ristrukturimit, njësia përgjegjëse (DAP), me vendimin nr. 6499/56, datë 04.12.2017, ka vendosur transferimin e përhershëm për **19** nëpunës civilë.

Në lidhje me vendimet e mësipërme dhe aktet individuale të njësisë përgjegjëse, për transferimin e përhershëm në kuadër të ristrukturimit, Komisioneri vëren, se brenda afatit 5 ditor, **72** nëpunësit e mësipërm kanë dërguar pranë njësisë përgjegjëse konfirmimet për pranimin e transferimit.

***i) Rastet e lirimt nga shërbimi civil, për shkak të ristrukturimit të institucionit të Ministrisë së Drejtësisë.***

Ligji nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, në nenin 50, pika 6, përcakton se përfundimi i marrëdhënieve në shërbimin civil, për shkak të ristrukturimit apo mbylljes së institucionit, nuk lejohet, me përjashtim të rastit kur, si pasojë e këtyre procedurave, ka shkurtime të numrit të përgjithshëm të nëpunësve civilë dhe transferimi, sipas pikës 2, të këtij neni, është i pamundur.

Komisioni i Ristrukturimit, pas konstatimit të pamundësisë së sistemimit të nëpunësve civilë, vendimin për përfundimin e marrëdhënies në shërbimin civil për shkak të mbylljes apo ristrukturimit të institucionit së bashku me relacionin arsyetues, ia dërgon njësisë së burimeve njerëzore të institucionit, e cila në zbatim të nenit 66, pika 1, germa a/1, deklaronte lirin nga shërbimi civil.

Në zbatim të pikave 7 dhe 8, të nenit 50, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, nëpunësi civil, që lirohet nga shërbimi civil për shkak të ristrukturimit të institucionit, gëzon të drejtën e dëmshpërblimit në përputhje me vjetërsinë e tij në punë, si dhe deklarimin e mundësisë që i njihet nga ligji që brenda një periudhe 2 (dy) vjeçare të konkurrojë nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele për pozicione të të njëjtës kategori dhe ngritjes në detyrë, për pozicione të lira, në një kategori më të lartë.

Nga verifikimi i praktikës, që materializon vendimmarrjen e Komisionit të Ristrukturimit, konstatohet se në **11** raste, është vendosur përfundimi i marrëdhënies në shërbimin civil, për shkak të ristrukturimit të Ministrisë së Drejtësisë. Bëhet fjalë për nëpunësit si më poshtë:

1. \*\*\*\*\*, emëruar në pozicionin “Drejtor”, i Drejtorisë së Teknologjisë së Informacionit, në Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimeve Mbështetëse – kategoria II-b. Me vendimin nr. 7146, datë 24.11.2017, të Komisionit të Ristrukturimit, për këtë nëpunës është propozuar përfundimi i marrëdhënies në shërbimin civil dhe me vendimin nr. 7146/2, datë 14.12.2017, të Sekretarit të Përgjithshëm, është vendosur liri nga shërbimi civil.

2. \*\*\*\*\*, emëruar në pozicionin “Përgjegjës Sektori”, në Sektorin e Teknologjisë së Informacionit dhe Statistikave, në Drejtorinë e Teknologjisë së Informacionit, në Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimeve Mbështetëse – kategoria III-a. Me vendimin nr. 7145, datë 24.11.2017, të Komisionit të Ristrukturimit për këtë nëpunës është propozuar përfundimi i marrëdhënies në shërbimin civil dhe me vendimin nr. 7145/1, datë 08.12.2017, të Sekretarit të Përgjithshëm, është vendosur lirimi nga shërbimi civil.
3. \*\*\*\*\*, emëruar në pozicionin “Specialist”, në Sektorin e Teknologjisë së Informacionit dhe Statistikave, në Drejtorinë e Teknologjisë së Informacionit, në Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimeve Mbështetëse – kategoria III-b. Me vendimin nr. 7147, datë 24.11.2017, të Komisionit të Ristrukturimit për këtë nëpunës është propozuar përfundimi i marrëdhënies në shërbimin civil dhe me vendimin nr. 7147/2, datë 08.12.2017, të Sekretarit të Përgjithshëm, është vendosur lirimi nga shërbimi civil.

Në lidhje me pozicionet, ku këta nëpunës kanë qenë të emëruar, Komisioneri konstaton se në strukturën aktuale të Ministrisë së Drejtësisë nuk është parashikuar njësi organizative e njësisë së teknologjisë së informacionit, fakt që nënkupton se këto pozicione janë suprimuar. Në lidhje me këtë rrethanë, rezulton se, në zbatim të vendimit nr. 673, datë 22.11.2017, të Këshillit të Ministrave, “Për riorganizimin e Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit”, strukturat përgjegjëse TIK në institucionet e administratës shtetërore, nën përgjegjësinë e Këshillit të Ministrave, bëhen pjesë e strukturës së AKSHI-t.

Në pikën 23, të këtij akti nënligjor, përcaktohet se, punonjësit aktuale të njësive të teknologjisë së informacionit e të komunikimit (NJTIK), në këtë institucione, kalojnë tek AKSHI brenda datës 23.12.2013 dhe këta nëpunës trajtohen në bazë të përcaktimeve të legjislacionit në fuqi për nëpunësit civilë, në rastin e mbylljes dhe ristrukturimit të institucionit, apo Kodit të Punës.

Në lidhje me sa më sipër, Komisioneri vëren se, vendimet e Komisionit të Ristrukturimit, për përfundimin e marrëdhënies në shërbimin civil, në rastin e nëpunësve \*\*\*\*\*, \*\*\*\*\* dhe \*\*\*\*\*, janë marrë në përputhje me përcaktimet e legjislacionit në fuqi.

Konstatohet se në aktin e lirit nga shërbimi civil, nëpunësve të mësipërm, u është njohur e drejta e dëmshpërblimit në përputhje me vjetërsinë e punës si e drejtë e përcaktuar në nenin 50, pika 7, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar.

Nga ana tjetër, konstatohet se, Departamenti i Administratës Publike, me qëllim garantimin e të drejtave të këtyre punonjësve, të liruar nga shërbimi civil për shkak të ristrukturimit, i është drejtuar Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit me shkresën nr. 6727 prot., datë 24.11.2017, duke kërkuar fillimin e procedurave për vijimin e marrëdhënies së punës për punonjësit e mësipërm, sipas përcaktimeve të aktit nënligjor që rregullon këtë aspekt.

4. \*\*\*\*\*, emëruar në pozicionin “*Drejtor*”, i Drejtorisë së Financës, në Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimeve Mbështetëse – kategoria II-b. Komisioneri, vëren se, fillimisht Komisioni i Ristrukturimit ka propozuar sistemimin e nëpunësit, në pozicionin Drejtor i Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse, në Drejtorinë e Shërbimit të Provës – kategoria III-a, për të cilin ky nëpunës nuk ka qenë dakord, fakt që materializohet në procesverbalin e mbajtur në datën 30.11.2017. Me vendimin nr. 7431 prot., datë 05.12.2017, Komisioni i Ristrukturimit ka propozuar përfundimin e marrëdhënies në shërbimin civil për këtë nëpunës, në pamundësi sistemimi. Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Drejtësisë, me aktin nr. 7431/1 prot., datë 11.12.2017, ka vendosur përfundimin e marrëdhënies në shërbimin civil, duke aplikuar të drejtën e dëmshpërblimit me pagën e 6 muajve;
5. \*\*\*\*\*, emëruar në pozicionin “*Drejtor*”, në Drejtorinë e Auditimit të Brendshëm – kategoria II-b. Me vendimin nr. 7273 prot., datë 04.12.2017, Komisioni i Ristrukturimit ka propozuar përfundimin e marrëdhënies në shërbimin civil.
6. \*\*\*\*\*, emëruar në pozicionin “*Drejtor*”, në Drejtorinë e Inspektimit të Institucioneve të Varësisë dhe të Profesioneve të Lira, në Drejtorinë e Përgjithshme e Planifikimit Strategjik & Inspektimit të Çështjeve të Drejtësisë – kategoria II-b. Me vendimin nr. 7272 prot., datë 04.12.2017, Komisioni i Ristrukturimit ka propozuar përfundimin e marrëdhënies në shërbimin civil për këtë nëpunës, në pamundësi sistemimi. Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Drejtësisë, me aktin nr. 7272/1 prot., datë 11.12.2017, ka vendosur përfundimin e marrëdhënies në shërbimin civil, duke aplikuar të drejtën e dëmshpërblimit me pagën e 6 muajve;

Nga analiza e strukturës aktuale, vërehet se pozicionet e nivelit të mesëm drejtues me emërtesën “*Drejtor Drejtorie*” – kategoria II-b, janë shtuar, konkretisht nga 10 në 11 pozicione. Pavarësisht këtij fakti, nga përmbajtja e dokumentacionit të administruar rezulton se, Komisioni i Ristrukturimit, pasi ka shqyrtuar dosjen e personelit të nëpunësve \*\*\*\*\*, \*\*\*\*\* dhe \*\*\*\*\*, ka arritur në konkluzionin se këta nëpunës nuk mund të sistemohen në pozicionet e lira të krijuara në Ministrinë e Drejtësisë, të cilat i përkasin nivelit të mesëm drejtues – kategoria e pagës II-b, pasi nuk përmbushin kriteret e veçanta të pozicionit, në referencë të përshkrimit të punës.

Rezulton se, në zbatim të nenit 50, pika 2, germa c, të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, Komisioni i Ristrukturimit ka shqyrtuar mundësinë e sistemimit të nëpunësve në fjalë në institucionet e varësisë së institucionit të ristrukturuar, duke arritur në përfundimin se nuk është gjendur ndonjë pozicion vakant në nivelin e mesëm drejtues, me kategorinë e pagës II-b.

Në kuadër të procesit të verifikimit, u konstatua se këta nëpunës aktualisht i janë drejtuar Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë me kërkesë padi, duke kërkuar shfuqizimin e akteve administrative të sipërcituara, si dhe rregullimin e pasojave juridike si pasojë e konstatimit të paligjshmërisë së këtyre akteve, për të bërë të mundur rikthimin e tyre në pozicionin e mëparshëm ose në një pozicion tjetër të së njëjtës kategori.

7. \*\*\*\*\* , emëruar në pozicionin “Përgjegjës Sektori”, në Sektorin e Marrëdhënieve me Publikun, në Drejtorinë e Teknologjisë dhe Informacionit, në Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimeve Mbështetëse – kategoria III-a. Me vendimin nr. 7274 prot., datë 04.12.2017, Komisioni i Ristrukturimit, ka propozuar përfundimin e marrëdhënies në shërbimin civil. Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Drejtësisë, me aktin nr. 7274/1 prot., datë 11.12.2017, ka vendosur përfundimin e marrëdhënies në shërbimin civil, duke aplikuar të drejtën e dëmshpërblimit me pagën e 6 muajve.
8. \*\*\*\*\* , emëruar në pozicionin “Përgjegjës Sektori”, në Sektorin e Inspektimit të Institucioneve të Varësisë dhe të Profesioneve të Lira, në Drejtorinë e Inspektimit të Institucioneve të Varësisë dhe të Profesioneve të Lira, Drejtoria e Përgjithshme e Planifikimit Strategjik & Inspektimit të Çështjeve të Drejtësisë – kategoria III-a. Me vendimin nr. 7433 prot., datë 05.12.2017, Komisioni i Ristrukturimit, ka propozuar përfundimin e marrëdhënies në shërbimin civil. Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Drejtësisë, me aktin nr. 7274/1 prot., datë 11.12.2017, ka vendosur përfundimin e marrëdhënies në shërbimin civil, duke aplikuar të drejtën e dëmshpërblimit me pagën e 9 muajve.

Për sa është parashtruar në përmbajtje të këtij raporti, miratimi i strukturës dhe organikës së re të Ministrisë së Drejtësisë është shoqëruar me shkurtim dhe suprimim të pozicioneve të nivelit të ulët drejtues, ku sipas strukturës së mëparshme në këtë kategori klasifikoheshin pozicionet me emërtesën “Përgjegjës Sektori” – kategori page IIIa ose III-a/1 dhe pozicionet me emërtesën “Inspektor” – kategori page III-a. (konkretisht nga 42 pozicione në 28 pozicione pune).

Në këto kushte, Komisioni i Ristrukturimit, në përfundim të shqyrtimit dhe vlerësimit të dosjeve të personelit të nëpunësve \*\*\*\*\* dhe \*\*\*\*\* , ka arritur në konkluzionin se sistemimi i këtyre nëpunësve në pozicione të nivelit të ulët drejtues, sipas strukturës së re të institucionit, nuk është i mundur, me arsyetimin se këta nëpunës nuk përmbushin kriteret e veçanta të përcaktuara në përshkrimin e punës.

Nga përmbajta e vendimeve për përfundimin e marrëdhënies në shërbimin civil, rezulton se, Komisioni i Ristrukturimit, ka shqyrtuar mundësinë e sistemimit të nëpunësve të mësipërm në pozicionet të tjera të shërbimit civil, duke arritur në përfundimin për pamundësinë e transferimit, pasi nuk rezultojnë pozicione të lira të së njëjtës kategori, për të cilat ata plotësojnë kriteret e veçanta dhe që përputhen me funksionet që këta punonjës kanë kryer aktualisht.

Nga dokumentacioni i administruar, rezulton se këta nëpunës, në zbatim të nenit 41, pika 3, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, kanë ushtruar të drejtën e ankimit pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, duke kërkuar shfuqizimin e akteve administrative të sipërcituara si dhe rikthimin në pozicionin e mëparshëm ose në një pozicion tjetër të së njëjtës kategori.

9. \*\*\*\*\* , emëruar në pozicionin “Inspektor”, në Sektorin e Inspektimit dhe Organizimit Gjyqësor, në Drejtorinë e Inspektimit Gjyqësor dhe Prokurorisë, në Drejtoria e Përgjithshme e Planifikimit Strategjik & Inspektimit të Çështjeve të



Drejtësisë – kategoria III-a. Me vendimin nr. 7434 prot., datë 05.12.2017, Komisioni i Ristrukturimit, ka vendosur të propozojë përfundimin e marrëdhënies në shërbimin civil për këtë nëpunës.

10. \*\*\*\*\*, emëruar në pozicionin “*Inspektor*”, në Sektorin e Inspektimit dhe Organizimit Gjyqësor, në Drejtorinë e Inspektimit Gjyqësor dhe Prokurorisë, në Drejtoria e Përgjithshme e Planifikimit Strategjik & Inspektimit të Çështjeve të Drejtësisë – kategoria III-a. Me vendimin nr. 7432 prot., datë 05.12.2017, Komisioni i Ristrukturimit, ka vendosur të propozojë përfundimin e marrëdhënies në shërbimin civil për këtë punonjës.
11. \*\*\*\*\*, emëruar në pozicionin “*Inspektor*”, në Sektorin e Inspektimit dhe Organizimit Gjyqësor, në Drejtorinë e Inspektimit Gjyqësor dhe Prokurorisë, në Drejtoria e Përgjithshme e Planifikimit Strategjik & Inspektimit të Çështjeve të Drejtësisë – kategoria III-a. Me vendimin nr. 7435 prot., datë 05.12.2017, Komisioni i Ristrukturimit, ka propozuar përfundimin e marrëdhënies në shërbimin civil. Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Drejtësisë, me aktin nr. 7435/1 prot., datë 11.12.2017, ka vendosur përfundimin e marrëdhënies në shërbimin civil, duke aplikuar të drejtën e dëmshpërblimit me pagën e 3 muajve.

Nga përmbajtja e vendimeve të mësipërme të Komisionit të Ristrukturimit, konstatohet se pozicioni “*Inspektor*”- kategori page III-a është konsideruar si pozicion i nivelit të ulët drejtues. Nisur nga fakti që në strukturën e re të Ministrisë së Drejtësisë, pozicionet “*Inspektor*” dhe funksionet e tyre janë suprimuar plotësisht, Komisioni i Ristrukturimit ka arritur në konkluzionin se transferimi i këtyre nëpunësve brenda organikës së Ministrisë së Drejtësisë është i pamundur.

Më tej, Komisioni i Ristrukturimit, pasi ka shqyrtuar mundësinë e transferimit të këtyre nëpunësve në institucione të tjera të administratës shtetërore, ka konstatuar se nuk ka pozicione të lira “*Inspektor*”, kategori page III-a, të së njëjtës kategori dhe si rrjedhojë ka propozuar përfundimin e marrëdhënies në shërbimin civil për këta nëpunës.

Në referencë të dokumentacionit të administruar, rezulton se, nëpunësi \*\*\*\*\*, duke mos qenë dakord me vendimin e Komisionit të Ristrukturimit, ka ankimuar këtë akt administrativ në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, duke kërkuar shfuqizimin e akteve administrative të sipërcituara si dhe rikthimin në pozicionin e mëparshëm ose në një pozicion tjetër të së njëjtës kategori.

Njëkohësisht, konstatohet se, nëpunësit \*\*\*\*\* dhe \*\*\*\*\*, nuk kanë ankimuar vendimin e Komisionit të Ristrukturimit në rrugë administrative apo në rrugë gjyqësore duke pranuar dëmshpërblimin dhe të drejtën për të konkurruar brenda afatit 2 vjeçar për lëvizje paralele apo ngritje në detyrë.

***j) Respektimi i afateve gjatë aplikimit të procedurës së ristrukturimit nga Komisioni i Ristrukturimit dhe Departamenti i Administratës Publike***



Një moment tjetër i mbikëqyrjes së procesit të ristrukturimit së aplikuar pranë Ministrisë së Mbrojtjes është verifikimi i afateve të përcaktuara në legjislacionin specifik që rregullon këtë aspekt.

Si rregull, njësia e burimeve njerëzore e institucionit, në momentin e miratimit të aktit të ristrukturimit apo mbylljes së institucionit, njofton individualisht nëpunësit për fillimin e procedurës së transferimit apo përfundimit të marrëdhënies në shërbimin civil për shkak të ristrukturimit apo mbylljes së institucionit. Efektet financiare për nëpunësit që do të transferohen apo do t'u përfundojë marrëdhënia e punësimit, fillojnë jo më shpejt se 1 (një) muaj nga momenti i njoftimit. (pika 15 e kreut II, të VKM nr. 125, dt. 17.2.2016).

Më tej, është parashikuar se, nëpunësi më i lartë civil i institucionin nën ristrukturim, jo më vonë se 2 ditë pas hyrjes në fuqi të aktit që ka miratuar ristrukturimin, i kërkon njësisë përgjegjëse (DAP), nxjerrjen e aktit për krijimin e Komisionit të Ristrukturimit. Më tej, njësia përgjegjëse (DAP), brenda 2 ditëve nga marrja e kërkesës krijon Komisionin e Ristrukturimit (sipas përcaktimeve të pikave 1, 1/1 e 2, të Kreut II, të Udhëzimit nr. 1, datë 01.03.2016, të Departamentit të Administratës Publike).

Pasi krijohet nga njësia përgjegjëse, Komisioni Ristrukturimit brenda 15 ditëve, nga momenti i krijimit të tij, i propozon njësisë përgjegjëse (DAP), vendimet mbi transferimin e nëpunësve civil (sipas përcaktimeve të pikës 16, të Kreut II, të Udhëzimit nr. 1, datë 01.03.2016, të Departamentit të Administratës Publike).

Në vazhdim, njësia përgjegjëse, brenda 10 ditëve, nga data e marrjes së propozimit për transferimin e nëpunësve civil nga Komisioni i Ristrukturimit, vendos për miratimin e propozimeve në fjalë, ose kthimin e akteve Komisionit në rastet kur vërteton parregullsi ligjore, i cili e rishqyrton brenda 5 ditëve (sipas pikës 20, Kreu II, të vendimit nr. 125, datë 17.2.2016, të Këshillit të Ministrave, si dhe si dhe pikës 18, të udhëzimi nr. 1, datë 1.3.2016, i DAP).

Në këtë rast, aktet nënligjore kanë parashikuar edhe njoftimin e vendimit të transferimit nëpunësit civil që transferohet dhe marrjen e mendimit të tij me shkrim brenda 5 (pesë) ditëve nga marrja e njoftimit; të drejtën e nëpunësit që të refuzojë vendimin dhe të dëgjohet nga njësia përgjegjëse brenda 5 ditëve dhe pas kësaj rikthimin e akteve për rivlerësim Komisionit, i cili duhet të japë mendimin e tij brenda 5 ditëve (sipas pikës 20 e 21 të kreut II, të vendimit nr. 125, datë 17.2.2016, të Këshillit të Ministrave, si dhe si dhe pikës 19, 20 e 21 të udhëzimi nr. 1, datë 1.3.2016, i DAP).

Në këto rrethana, nëse do të aplikoheshin të gjitha fazat e procesit të ristrukturimit, si dhe afatet procedurale të ankimit, si dhe duke llogaritur vonesat në marrjen e njoftimit nga subjektet e përcaktuara në aktet rregullative të përmendura më sipër, atëherë i gjithë ky proces parashikohet që të kryhet brenda një afati kohor që zgjat rreth 60 ditë kalendarike.

Referuar bazës ligjore si më sipër, rezulton se gjatë kryerjes së veprimeve administrative në kuadër të mbylljes apo ristrukturimit të institucionit, duhet të respektohen edhe afatet procedurale të parashikuara për këtë rast.

Për sa është parashtruar në përmbajtje të këtij raporti, rezulton se, procedura e shqyrtimit të mundësisë së sistemimit të nëpunësve civilë në kuadër të ristrukturimit të Ministrisë së Drejtësisë është kryer në dy faza, të cilat janë materializuar në vendimet respektive të Komisionit të Ristrukturimit dhe Departamentit të Administratës Publike.

Nga verifikimi i afateve gjatë aplikimit të procedurës së ristrukturimit rezulton se, nga momenti i miratimit të aktit që ka miratuar strukturën e re, konkretisht data 05.10.2017, faza e parë e procedurës së ristrukturimit ka përfunduar në datën 10.11.2017, pra për **36 ditë**. Sipas dokumentacionit përkatës, rezulton se faza e dytë ka përfunduar në datë 04.12.2017, pra për **60 ditë**.

Në dispozitat ligjore që rregullojnë procedurën e ristrukturimit, ligjvënësi ka përcaktuar të vendosë afatet procedurale të përmendura më sipër, për të disiplinuar këtë proces me qëllim që procesi të mos zvarritet. Megjithatë, vlen të theksohet se, afati i mësipërm ligjor shërben si një garant në kushtet e zhvillimit të një procesi ristrukturimi në rrethana të zakonshme.

Në rastin konkret, për sa është pasqyruar në përmbajtje të këtij raporti, rezulton se ndodhemi në kushtet e riorganizimit tërësor të aparatit shtetëror, i cili është shoqëruar me ndryshim të theksuar të mënyrës së funksionimit të ministrive, misionit të tyre si dhe të riformatimit të njësive organizative, fakt që kërkon një periudhë më të gjatë kohore të realizimit të procedurës së ristrukturimit.

Në rastin konkret Komisioneri vlerëson se, aplikimi i procesit të ristrukturimit nga aktorët e caktuar nga ligji është realizuar *brenda afateve* ligjore, duke përmbyllur këtë proces pa zvarritje.

#### **IV. Konkluzione**

Nga gjithë sa u analizua më sipër, në mbështetje të dokumentacionit të administruar gjatë procesit të verifikimit, Komisioneri arrin në konkluzionin dhe vlerëson se:

1. Procedura e ndjekur nga Komisioni i Ristrukturimit për nxjerrjen e akteve administrative për propozimin e transferimit të **72** nëpunësve civilë, për të cilët pozicionet e punës janë prekur si rrjedhojë e ristrukturimit të administratës së Ministrisë së Drejtësisë, si dhe procedura e kryer nga njësia përgjegjëse, Departamenti i Administratës Publike, deri në nxjerrjen e akteve administrative individuale për miratimin e transferimeve në fjalë, janë kryer në përputhje me përcaktimet e nenit 50, të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, vendimit nr. 125, datë 17.02.2016, të Këshillit të Ministrave, “*Për transferimin e përkohshëm dhe të përhershëm të nëpunësve civilë*”, si dhe të Udhëzimit nr. 1, datë 01.03.2016, të Departamentit të Administratës Publike, “*Për krijimin, funksionimin dhe kompetencat e Komisionit të Ristrukturimit për shkak të mbylljes apo ristrukturimit të institucionit*”.

Komisioneri konstaton se, në **72** rastet e nëpunësve civilë të përfshirë në ristrukturim, në asnjë rast nuk e kanë refuzuar vendimin përfundimtar për transferimin në kuadër të ristrukturimit, ç’ka provohet me miratimin e tyre të

materializuar në deklaratat e depozituara pranë Departamentit të Administratës Publike.

2. Në lidhje me disa parregullsi të evidentuara në përmbajtje të këtij raporti, vlen të theksohet se, ato nuk kanë cenuar përmbajtjen e procesit të vendimmarrjes në lidhje me transferimet e nëpunësve civilë, por janë theksuar me qëllim që të mbahen parasysh në të ardhmen.
3. Në rastin e punonjësve \*\*\*\*\*, \*\*\*\*\*, \*\*\*\*\*, \*\*\*\*\*, \*\*\*\*\* dhe \*\*\*\*\*, për të cilët është vendosur lirimi nga shërbimi civil për shkak të ristrukturimit, vlerësohet se kjo çështje do të marrë zgjidhje përfundimtare në rrugë gjyqësore, pasi mosmarrëveshja administrative në lidhje me marrëdhënien e shërbimit civil në një rast ristrukturimi është objekt për t'u shqyrtuar në Gjykatën Administrative, si organi kompetent në këtë rast në përputhje me nenin 41, pika 3, të ligjit për nëpunësin civil.

Nga gjithë sa u analizua më sipër, bazuar në nenin 16, pika 6, të Kreut III, të Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, ankesat e paraqitura nga punonjësit e mësipërm, janë arkivuar dhe për këtë fakt të njoftohen të gjithë ankuesit.

\*  
\*   \*

Këto ishin rrethanat e konstatuara gjatë procesit të monitorimit të procedurave të kryera në kuadër të ristrukturimit të institucionit Ministria e Mbrojtjes, në lidhje me zbatimin e ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe akteve nënligjore të dala në bazë e për zbatim të tij.

**KOMISIONERI**

**Pranvera Strakosha**